

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot më 02/09/2022 ortaku i shoqërisë “Green Line” sh.p.k. me NIPT L91924024I, Shoqëria “CFO PHARMA” sh.p.k. me NIPT K22035002U e përfaqësuar nga ortaku i vetëm Z. Nadir Çausholli, lindur në Tiranë, në 14.02.1978 identifikuar nga Leternjoftimi Nr. 034193288 dhe Z. Nadir Çausholli, lindur në Tiranë, në 14.02.1978 identifikuar nga Leternjoftimi Nr. 034193288. Të dy palët si dhuruesi dhe pranuesi janë dakord me dhurimin e kuotave.

**Palët janë:**

**Dhuruesi:** Shoqëria “CFO PHARMA” sh.p.k. me NIPT K22035002U e përfaqësuar nga ortaku i vetëm Z. Nadir Çausholli, lindur në Tiranë, në 14.02.1978 identifikuar nga Leternjoftimi Nr. 034193288.

**Pranuesi:** Z. Nadir Çausholli, lindur në Tiranë, në 14.02.1978 identifikuar nga Leternjoftimi Nr. 034193288.

### Neni 1: Objekti kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhurimi i pjesëmarrjes në përqindje 100% të Shoqërisë “CFO PHARMA” sh.p.k. me NIPT K22035002U e përfaqësuar nga ortaku i vetëm Z. Nadir Çausholli që zotëron tek shoqëria “Green Line” sh.p.k. për tek Z. Nadir Çausholli.

### Neni 2: Vlera e dhurimit

Palët bien dakord që vlera e dhurimit të 100% të pjesëmarrjes në përqindje që Shoqëria “CFO PHARMA” sh.p.k. me NIPT K22035002U e përfaqësuar nga ortaku i vetëm Z. Nadir Çausholli ka tek shoqëria “Green Line” sh.p.k. është ajo e vlerës 240.314.994,00. Këto kuota do i dhurohen Z. Nadir Çausholli. Palët nuk kanë asnjë pretendim kundrejt njëri-tjetrit, përsa i përket këtij neni.

### Neni 3: Kalimi i pronësisë

Hyrja në fuqi e kontratës do te realizohet kur nënshkruhet nga palët. Ekzekutimi i veprimeve për kalimin e plotë të pronësisë do të realizohet pranë Q.K.B.

### Neni 4: Të drejtat dhe detyrimet e Dhuruesit

**Dhuruesi** merr përsipër, garanton dhe siguron pranuesin se deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe të nënshkrimit të Kontratës, kuotat e mësipërme janë:

1. Të lira nga cdo lloj barre dhe pengu;
2. Nuk jane objekt i ndonje konflikti gjyqësor
3. Nuk ka persona të tretë që të kenë pretendime në lidhje me pronësinë mbi këto kuota.

**Pranuesi** është i detyruar të paguaje tatimin mbi të ardhurat nga dhurimi, në qoftë se do të ketë, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

### Neni 5: Të drejtat dhe detyrimet e Pranuesit

Ai ka të drejtë të gëzojë i qetë kuotat nga **Dhuruesi** dhe në rast të kundërt, të kërkojë nga ky i fundit të zgjidhë konfliktin që mund të vijë nga të tretët, për probleme të lindura përpara datës së dhurimit së kuotave.

### Neni 6: Interpretimi i kontratës në tërësi

Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë kontratë.

### Neni 7: Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

Të gjitha mosmarreshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, janë objekt shqyrtimi para Gjykates së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **DHURUESI**

**Shoqëria “CFO PHARMA” sh.p.k.  
E përfaqësuar nga ortaku i vetëm  
Z. Nadir Çausholli**

#### **PRANUESI**

**Z. Nadir Çausholli**

*Nadir Çausholli*

*Nadir Çausholli*  
*Nadir Çausholli*